



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 8.3.2023

Nr: 125

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PARTIA BALLI KOMBËTAR DEMOKRAT” PËR
REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË
DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë, 8.3.2023 në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 1263 Prot., datë 2.3.2023, me:

Kërkues: Partia politike “Partia Balli Kombëtar Demokrat”, me kryetar z. Artur Roshi

Objekti: Regjistrimi i partisë “Partia Balli Kombëtar Demokrat” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023

Baza ligjore: Neni 64 i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

“Partia Balli Kombëtar Demokrat”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Artur Roshi, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023, administruar.

Data: 8.3.2023 Nr: 125
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Balli Kombëtar Demokrat”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 2.3.2023, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia Balli Kombëtar Demokrat”, me iniciale “PBKD”, me kryetar z. Artur Roshi rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike, (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia Balli Kombëtar Demokrat” me shkronja nistore “PBKD”, me adresë Rruga “Hysni Gërbolli”, pranë Kryqit të Kuq Shqiptar, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Artur Roshi, me adresë Rruga “Hysni Gërbolli”, Vilë Private, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është z. Sina Vrapi, me adresë Rruga “Don Bosko”, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është z. Enea Cenko, me adresë, Rruga “Hysni Gërbolli”, Pallati pranë Kryqit të Kuq, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia Balli Kombëtar Demokrat”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues kërkesës, i paraqitur nga “Partia Balli Kombëtar Demokrat”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, nenin 64, pika 2 dhe nenin 92 /2 pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të udhëzimit nr.1, datë 18.1.2023, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”

VENDOSA:

Data: 8.3. 2023 Nr: 125
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Balli Kombëtar Demokrat”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia Balli Kombëtar Demokrat”, me kryetar z. Artur Roshi, me shkronjat nistore “PBKD”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI